



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1275/ 11 prot.

Datë 31/07/2026

V E N D I M
Nr. 914/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31/07/2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 810/2026, datë 16.06.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026”, me fond limit 6,486,240 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK me NIPT L28029301Q me adresë: Fshatin Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit, Kurbin

Operatori ekonomik “Medi Tel” SHPK me NIPT J71519004Ë dhe me adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Km.1, Rruga Vidhëgjatë, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr. Pronësisë 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 16.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 810/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026”, me fond limit 6,486,240 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medi Tel” SHPK për procedurën e prokurimit më sipër cituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Medi Tel” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operatorë ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e finances, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Medi Tel” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1431/11 prot, datë 25.06.2026, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit Prokurimit Publik Nr. 810/2026, datë 16.06.2026” protokolluar me tonën me nr. 1275/8 prot, datë 29.06.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a., ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit KPP 810/2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026”, me fond limit 6,486,240 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1431/11 prot, datë 25.06.2026, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit Prokurimit Publik Nr. 810/2026, datë 16.06.2026” protokolluar me tonën me nr. 1275/8 prot, datë 29.06.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a., ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit KPP 810/2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026”, me fond limit 6,486,240 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 810/2026 datë 16.06.2026, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 810/2026, datë 16.06.2026 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026”, me fond limit 6,486,240 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo